



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Draft

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE, 2019-2021

Malishevë, Qershor 2018

PËRBMAJTJA

| | |
|--|----|
| 1.Hyrje | 3 |
| 2.Deklarata e Komunës ne lidhje me prioritetet strategjike te zhvillimit | 4 |
| Profili i shkurtër socio-ekonomik i komunës..... | 4 |
| 3.Korniza afatmesme buxhetore | 6 |
| Objektivat e kornizës afatmesme buxhetore | 6 |
| 4.Korniza ekonomike fiskale | 7 |
| Perspektiva e politikave fiskale | 10 |
| 5.Përshkrimi i të hyrave vetanake..... | 11 |
| Planifikimi i te hyrave komunale, për periudhën 2019-2021..... | 11 |
| 6.Strategjia zhvillimore për sektorët komunal | 21 |
| 7.Menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve | 23 |
| 8. Programi komunal i investimeve publike (PIP)..... | 24 |
| 9. Korniza e performances së shpenzimeve të njësisve buxhetore..... | 24 |
| Zyra e kryetarit..... | 24 |
| Performanca: | 25 |
| Zyra e kuvendit të komunës | 27 |
| Performanca: | 27 |
| Drejtoria për administrat të përgjithshme | 28 |
| Performanca: | 30 |
| Drejtoria për buxhet dhe financa..... | 31 |
| Performanca: | 32 |
| Drejtoria për gjeodezi dhe kadastër | 34 |
| Performanca: | 35 |
| Drejtoria e inspeksionit | 36 |

| | |
|--|----|
| Performanca: | 37 |
| Drejtoria e urbanizimit | 39 |
| Performanca: | 39 |
| Drejtoria për shëndetësi dhe mirqenje sociale | 42 |
| Performanca: | 43 |
| Drejtoria e arsimit | 44 |
| Performanca: | 44 |
| Drejtoria e kulturës, rinisë dhe sportit..... | 46 |
| Performanca: | 46 |
| Drejtoria e shërbimeve publike | 48 |
| Performanca: | 49 |
| Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim (Emergjencë) | 50 |
| Performanca: | 50 |
| Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural | 51 |
| Performanca: | 52 |

1.HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritarë, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore,përmban një detyrim per programe-nenprogramet buxhetore te Komunës te kerkuara nga Qarkorja Buxhetore Komunale nr.2019/1 per Komunat e Kosoves e leshuar nga Ministria e Financave .

Ky dekument do te jete bazë per percaktimin e sektoreve te zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve ne Komunë dhe shprendarjen e të hyrave Komunale për periudhën 2019-2021.

Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhen 2019-2021, do te hartohet,ndryshohet,plotësohet dhe do te aprovohet sipas procedurave te percaktuara me Qarkoren Buxhetore te Ministrisë per Financa dhe do te kaloj nëpër kater faza si vijon:

- **Faza e parë:** KAB,si draft ,percaktimi i sektoreve dhe prioriteteve komunale.
- **Faza e dytë:**KAB,konsultimet ne organet e komunes dhe subjektet tjera me interes.
- **Faza e tretë:**KAB,shqyrtohet dhe miratohet ne Komitetin per politik dhe financa, dhe
- **Faza e katër:**KAB,shqyrtohet dhe miratohet ne Kuvendin e Komunes dhe dorëzohet ne Ministrinë e Financave para 30 qershorit 2018.

2.DEKLARATA E KOMUNËS NE LIDHJE ME PRIORITETET STRATEGJIKE TE ZHVILLIMIT

Profili i shkurtër socio-ekonomik i komunës

Komuna e Malishevës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, respektivisht në pjesën lindore të Rrafshit të Dukagjinit. Territori i komunës përfshinë një sipërfaqe prej 306.48 Km² (2.8% të territorit të Kosovës), dhe shtrihet në një gjerësi prej 42° dhe 28'41" dhe gjatësi prej 20° 44'33". Kufizohet me komunat e Drenasit, Lipjanit,Suharekës, Rahovecit dhe Klinës.

Konfiguracioni i përshtatshëm i terrenit i mundëson komunës që të ketë lidhje të mira të komunikacionit me të gjithë vendin Me shumicën e qyteteve kryesore të Kosovës lidhet brenda një distance prej rreth 40-55 km - Gjakovë 40 km, Prizren 44 km, Prishtinë 49 km, Pejë 52 km, Ferizaj 56 km, Mitrovicë 75 km, Gjilan 80 km. Sa i përket lidhjeve ndërshtetërore, kalimi i autostradës Durrës-Merdarë përmes territorit të komunës e vë Malishevën në pozitë të volitshme

për lidhje rrugore rajonale ndërkombëtare. Autostrada Durrës-Merdarë i mundëson lidhje të lehtë dhe të shpejtë me Republikën e Shqipërisë dhe portin e Durrësit ndërsa planet për vazhdimin e mëtutjeshëm të kësaj autostrate, si dhe ndërtimi i autostradës së re për Han të Elezit do ti mundësojnë lidhje cilësore dhe të shpejta me shtetet dhe korridoret rajonale të transportit.

Përveç avantazheve të lidhjeve ekzistuese dhe atyre të planifikuara, pozita e komunës së Malishevës ofron përparësi edhe sa i përket vlerës dhe burimeve natyrore. Hapësira komunale që kufizohet me terrenet kodrinore në pjesën lindore (e cila është e kufizuar me Drenasin, Lipjanin dhe Suharekën) dhe në Jugperëndim (që kufizohet me Rahovecin), dhe shtrirja e sipërfaqeve të rrafshëta në qendër, ofrojnë një larmi të përmbajtjeve sa i përket potencialeve bujqësore, mjedisore dhe biodiversitetit. Një numër relativisht i madh i burimeve natyrore dhe kulturore që ky territor i posedon krijojnë një trashëgimi të larmishme dhe me vlerë.

Si një aset i veçantë duhet të ceket Ujëvara panoramike e Mirushës që ndodhet në kufirin e komunës së Klinës dhe Malishevës. Për shkak të vlerave që ka kjo zonë është shpallur Monument Natyror me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës", me një sipërfaqe prej 598.4 ha, i cili shtrihet në komunat e Malishevës, Klinës dhe Rahovecit.

Sipas regjistrimit të fundit (2011), në Komunën e Malishevës jetojnë 54.613 banorë, që përbëjnë 3.14% të banorëve të Kosovës. Prej numrit të gjithëmbarshtëm të banorëve në komunë, 3395 (6.22%) jetojnë në zonën urbane, që është dukshëm më e ulët se mesatarja e Kosovës prej 38%.

Bujqësia paraqet potencialin kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës, ndërsa nuk është trashëguar ndonjë industri nga periudha e para luftës. Malisheva ka kushte të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtysë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës.

Potencialet për zhvillim ekonomik nuk janë shfrytëzuar plotësisht deri më tani, ndërsa Malisheva i takon komunave më të pazhvilluara të Kosovës. Burimi kryesor i gjenerimit të të hyrave të qytetarëve të komunës së Malishevës janë prodhimtaria e vogël, bujqësia (ekonomitë familjare) dhe tregtia. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme.

3.KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

Korniza afatmesme buxhetore e komunës është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e cila është e ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2019-2021 të dhëna nga MF-i përmes qarkores buxhetore 2019/1.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet i procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB–Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioriteteve të tanishme dhe afatmesme të Malishevës si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2019-2021.

Objektivat e kornizës afatmesme buxhetore

Me Kornizën afatmesme buxhetore 2019-2021 të Komunës së Malishevesë, synohet të arrihen këto objektiva :

zhvillimin ekonomik;

planifikimin urban dhe rural;

shfrytëzimin e tokës;

zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;

mbrojtjen e mjedisit lokal;

formimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve, drenazheve, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transporti lokal;

përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;

ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm;

promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

ofrimin e për kujdesit publik primar shëndetësor;

ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për strehim familjar raste emergjente, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit;

banimin publik;

shëndetësinë publike;

licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;

emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;

aktivitetet kulturore dhe të lira.

4.KORNIZA EKONOMIKE FISKALE

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 të hartuar nga Qeveria e Kosovës.

Tabela 1. Pagat dhe Meditjet

| Kodi | Programet buxhetore | Buxheti aktual | Parashikimet | | | |
|--------------|----------------------------|-----------------------|---------------------|-------------|-------------|-------------|
| | | | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
| Prog. | | | | | | |
| 160 | Zyra e Kryetarit | 40.854 | 41.950 | 41.950 | 41.950 | |
| 169 | Zyra e Kuvendit Komunal | 103.517 | 119.337 | 119.337 | 119.337 | |

| | | | | | |
|-------|---------------------------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| 163 | Administrata dhe Personeli | 258.053 | 248.693 | 248.693 | 248.693 |
| 175 | Buxheti dhe Financat | 143.689 | 143.990 | 143.990 | 143.990 |
| 180 | Shërbimet Publike dhe Emergjencia | 187.947 | 190.900 | 190.900 | 190.900 |
| 195 | Zyra Kom.për Komunitete | 5.914 | 5914 | 5914 | 5914 |
| 470 | Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvill. Rural | 118.574 | 119.500 | 119.500 | 119.500 |
| 650 | Gjeodezia | 54.195 | 54.500 | 54.600 | 54.600 |
| 660 | Planifikimi Urban dhe Mjedisi | 48.954 | 49.300 | 49.300 | 49.300 |
| 730 | Shëndetsia dhe Mirëqenia Sociale | 882.231 | 905.200 | 905.200 | 905.200 |
| | Kulturë Rini dhe Sportë | 47.203 | 47.800 | 47.800 | 47.800 |
| 75561 | Sherbimet sociale | 63.436 | 43.600 | 43.600 | 43.600 |
| 920 | Arsimi dhe Shkenca | 6.135.577 | 6.290.000 | 6.290.000 | 6.290.000 |
| | TOTALI: | 8.090.144 | 8.272.507 | 8.272.507 | 8.272.507 |


Duke u bazuar në kornizën në fjalë dhe parametrat tjerë në lidhje me të hyrat dhe të dalurat në periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet që sektorët e komunës do të kenë këto të hyra dhe të dala:

Tabela 2. Buxheti aktual 2018 dhe kufijt buxhetor për periudhën 2019 - 2021

| Sektorët kryesor | Buxheti | Parashikimet | | |
|--------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
| Granti i përgjithshëm | 4,915,440.00 | 5,079,524.00 | 5,529,661.00 | 5,881,261.00 |
| Granti i Arsimit | 6,678,124.00 | 6,548,086.00 | 6,578,695.00 | 6,609,461.00 |
| Granti i Shenetësisë | 1,514,464.00 | 1,638,390.00 | 1,720,310.00 | 1,806,325.00 |
| Huamarrja për arsim | 44,828.00 | 29,885.00 | - | - |
| Huamarrja për shendetësi | 131,071.00 | 131,071.00 | - | - |
| THV | 819,797.00 | 921,023.00 | 952,782.00 | 984,542.00 |
| Gjithsej: | 14,103,724.00 | 14,347,979.00 | 14,781,448.00 | 15,281,589.00 |

Grafiku- Buxheti aktual 2018, dhe kufit buxhetor 2019-2021

Buxheti 2018 dhe parashikimet 2019-2021



PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE

Ky seksion bazohet në informatat dhe analizat e përfshira në Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2019-2021. Veç kësaj, vëmendje e duhur i është kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave dhe politikës së shpenzimeve), zotimeve të Qeverisë së Kosovës të përfshira në Memorandumin e politikave ekonomike e fiskale.

Seksioni bënë prezantimin e shkurtër lidhur me mënyrën e zotimit të planifikuar të qeverisjes lokale, lidhur me politikat fiskale që ndikojnë në buxhetin e komunës të ndërlidhura me ndryshimet në kufijtë në mes të shpenzimeve operative (pagat+ mëditjet dhe mallrat + shërbimet), si dhe shpenzimeve kapitale, që do të reflektohen në përmirësimin e infrastructures publike në njërin anë, si dhe në sigurimin e kushteve të mundshme në drejtim të rritjes së arkëtimit të taksave, ngarkesave dhe tatimit në pronë. Të gjitha këto do të jenë si rezultat i ngritjes dhe promovimit të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektshmërisë.

5.PËRSHKRIMI I TË HYRAVE VETANAKE

Të hyrat komunale të komunes tonë realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushteti Lokal, Rregullores mbi Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë lloje të ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë: Tatimi në pronë, Taksat nga ushtrimi i veprimtaris afariste dhe taksat komunale për leje ndërtimi të cilat të hyra duhet të shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e investimeve kapitale në infrastrukturen rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që iu kthehen qytetarve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale

Të hyrat vetanake të komunës përbehen nga:

- Tatimi në pronë
- Taksat për ushtrim të veprimtaris afariste
- Taksat për regjistrimin e veturave
- Taksa administrative komunale
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa për shërbime kadastrale
- Taksa për përcaktimin e hipotekës
- Taksa për qertifikata (lindjes, kurorizimit, vdekjes),
- Të hyrat nga qiraja e objekteve komunale
- Të hyrat nga Arsimi.
- Të hyrat nga Shendetësia dhe
- Të hyrat tjera

PLANIFIKIMI I TE HYRAVE KOMUNALE, PËR PERIUdhËN 2019-2021

Për periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet rritja e të hyrave duke u bazuar në këta faktor:

- ✓ ekzistimi i borxheve të bartura,
- ✓ implementimi i instrumenteve ligjore për zbatim,
- ✓ mbledhja e qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale nga ndërmarrjet ose personat fizik ,
- ✓ të hyrat e tatimit në pronë dhe
- ✓ taksat – ngarkesat tjera

Për të bërë planifikimin dhe shpërndarjen e drejtë për të dalat publike me Kornizën afatmesme buxhetore komunale 2019-2021, në mënyrë të saktë egzistojnë vështirësi nga se mungojnë tregues të saktë zhvillimor.

Në drejtim të shpërndarjes dhe planifikimit të drejtë të parasë publike në këtë vit është përdorur në nivel të Kosovës, formula me të cilën janë paraparë indikatorët –kriteret, për shpërndarjen e granteve.

Për shpërndarjen e Grantit të përgjithshëm në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- popullsia e komunës,
- sipërfaqja e komunës,
- komunat e minoriteteve,
- popullsia e minoriteteve në komunë dhe
- shuma fikse për komuna.

Për shpërndarjen e Grantit specifik për arsim në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- numri i shkollave në komunë,
- numri i nxënësve në shkolla fillore,
- numri i nxënësve në shkolla të mesme,
- numri i nxënësve shumicë si dhe
- numri i nxënësve pakicë.

Për shpërndarjen e Grantit specifik për shëndetësi në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- popullsia në komunë dhe
- numri mesatar i kontrolleve për kokë banori.

Në bazë të kriterëve të përcaktuara me parë është planifikuar që ndarja e granteve do të bëhet në mënyrë të drejtë dhe do i përmbush të gjitha nevojat fiskale për tërë sektorët në nivel komunal.

Bazë për planifikimin e të hyrave, ka shërbyer Qarkorja buxhetore 2019/1, për komunat, e lëshuar nga MEF, ku janë paraqitur kufinjët e granteve të aprovuara nga Komisioni i granteve të ndarë si Granti i Përgjithshëm, Granti për Arsim, dhe Granti për Shëndetësi, si dhe parashikimi i të hyrave vetanake të komunës sipas fushave kryesore të hyrave duke u bazuar në politikat e të hyrave të komunës. Ky skision përfshin tabelën e cila prezanton planifikimin e të hyrave të komunës nga të gjitha burimet, në bazë të fushave kryesore të hyrave për tri vitet e ardhshme duke prezantuar edhe vitin aktual 2018.

Tabela 3. Plani Afatmesem i të hyrave totale të buxhetit për periudhën 2019-2021

| Nr. | Përshkrimi | Buxheti-2018 | Buxheti-2019 | 2020 Vlerësimi | 2021 Vlerësimi |
|------------|--|---------------------|---------------------|---------------------------|---------------------------|
| a | b | c | d | e | f |
| 1,1 | TË HYRAT VETANAKE | | 921.023 | 952.782 | 984.542 |
| 1.1.1 | Tatimi në pronë | | 300.000 | 325.000 | 325.000 |
| 1.1.2 | Taksat komunale | | 280.000 | 280.000 | 280.000 |
| | Licencat dhe lejet (taxat e bizneseve) | | 32.000 | 32.000 | 32.000 |
| | Certifikatat dhe dokumentet zyrtare | | 53.000 | 53.000 | 53.000 |
| | Taksat e pajisjeve motorike | | 80.000 | 80.000 | 80.000 |
| | Lejet për ndërtesa | | 60.000 | 60.000 | 60.000 |
| | Taksat tjera komunale | | 55.000 | 55.000 | 55.000 |
| 1.1.3 | Ngarkesat komunale | | 273.023 | 277.782 | 299.542 |
| | Ngarkesat regullatore | | | | |
| | Të hyrat nga qiraja | | 30.000 | 30.000 | 30.000 |
| | Bashkë-pagesat për arsim | | 35.000 | 35.000 | 40.000 |
| | Bashkë-pagesat për shëndetësi | | 55.000 | 55.000 | 55.000 |
| | Ngarkesat tjera komunale (gjobat) | | 153.023 | 157.782 | 174.542 |
| 1.1.4 | Të hyrat tjera | | 68.000 | 70.000 | 80.000 |
| 1.1.5 | Shitja e aseteve | | | | |
| 1.1.6 | Grantet dhe donacionet | | | | |
| | Vendore | | | | |

| | | | | | |
|-------|---------------------------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| | Të huaja | | | | |
| | Transferet Qeveritare | | | | |
| 1.2.1 | Granti i përgjithshëm | 4.915.440 | 5.079.524 | 5.529.661 | 5.881.261 |
| 1.2.2 | Granti për arsim | 6.674.124 | 6.548.086 | 6.578.695 | 6.609.461 |
| | Financim nga Huamarrja për arsim | 44.828 | 29.885 | 0 | 0 |
| 1.2.3 | Granti specifik për shëndetësi | 1.514.464 | 1.638.390 | 1.720.310 | 1.806.325 |
| 1.2.4 | Financim nga Huamarrja për shëndetësi | 131.071 | 131.071 | 0 | 0 |
| | Totali: | | | | |

Tabela 4. Buxheti i të gjitha kategorive ekonomike sipas Qarkores nr. 2019/1

Verzioni I.Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Mbrenda kufive buxhetor për vitin 2019

Tabela e Buxhetit 4.1 Komuna,Shëndetsia dhe Arsimi

| 625 | | | Stafi | Pagat | M/SH | Komunalit | Subvencionet | Kapitalet | Totali-2019 |
|--------------|-------------------------|-------------------------|--------------|------------------|------------------|----------------|----------------|------------------|-------------------|
| | Malishevë | TOTAL SHPENZIMET | 1,287 | 8,272,507 | 1,250,002 | 305,000 | 276,130 | 4,244,341 | 14,347,979 |
| | | Grantet Qeveritare | 1,287 | 8,239,507 | 953,931 | 305,000 | 0 | 3,785,494 | 13,283,931 |
| | | Të hyrat vetanake | 0 | 33,000 | 165,000 | 0 | 276,130 | 446,893 | 921,023 |
| | | Financim nga huamarrja | 0 | 0 | 131,071 | 0 | 0 | 11,954 | 143,025 |
| 160 | Zyra e Kryetarit | | 3 | 40,854 | 15,000 | 0 | 36,130 | 0 | 91,984 |
| | | Grantet Qeveritare | 3 | 40,854 | 15,000 | 0 | 0 | 0 | 55,854 |
| | | Të hyrat vetanake | 0 | 0 | 0 | 0 | 36,130 | 0 | 36,130 |
| | | Financim nga huamarrja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 16013 | Zyra e Kryetarit | | 3 | 40,854 | 15,000 | 0 | 36,130 | 0 | 91,984 |
| | | Grantet Qeveritare | 3 | 40,854 | 15,000 | | 0 | | 55,854 |
| | | Të hyrat vetanake | 0 | | | 0 | 36,130 | 0 | 36,130 |
| | | Financim nga huamarrja | 0 | | | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | |
|--------------|---|-----------|----------------|----------------|----------------|---------------|----------------|------------------|
| 169 | Zyra e Kuvendit Komunal | 3 | 119,337 | 50,000 | 0 | 10,000 | 0 | 179,337 |
| | Grantet Qeveritare | 3 | 119,337 | 40,000 | | 10,000 | | 169,337 |
| | Të hyrat vetanake | 0 | | 10,000 | | | | 10,000 |
| | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | |
| 163 | Administrata dhe personeli | 43 | 248,693 | 302,609 | 0 | 0 | 0 | 551,302 |
| | Grantet Qeveritare | 42 | 248,693 | 209,609 | 0 | 0 | 0 | 467,662 |
| | Të hyrat vetanake | 0 | 0 | 93,000 | | 0 | 0 | 93,000 |
| | Financim nga huamarrja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 16313 | Administrata | 42 | 241,733 | 289,609 | 0 | 0 | 0 | 538,302 |
| | Grantet Qeveritare | 42 | 241,733 | 196,609 | 0 | 0 | 0 | 445,302 |
| | Të hyrat vetanake | 0 | | 93,000 | | | | 93,000 |
| | Financim nga huamarrja | 0 | | 0 | | | | 0 |
| 16502 | Çështjet gjinore | 1 | 6,960 | 5,000 | 0 | 0 | 0 | 11,960 |
| | Grantet Qeveritare | 1 | 6,960 | 5,000 | 0 | 0 | 0 | 11,960 |
| | Të hyrat vetanake | 0 | | | | | | 0 |
| | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | 0 |
| 175 | Buxheti dhe financat | 24 | 143,689 | 57,700 | 0 | 0 | 324,893 | 526,282 |
| | Grantet Qeveritare | 24 | 143,689 | 25,700 | 0 | 0 | 0 | 169,389 |
| | Të hyrat vetanake | 0 | 0 | 32,000 | 0 | 0 | 324,893 | 356,893 |
| | Financim nga huamarrja | 0 | 0 | | | | 0 | 0 |
| 17513 | Buxhetimi | 24 | 143,689 | 57,700 | 0 | 0 | 324,893 | 526,282 |
| | Grantet Qeveritare | 24 | 143,689 | 25,700 | 0 | | | 169,389 |
| | Të hyrat vetanake | 0 | | 32,000 | | | 324,893 | 356,893 |
| | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | 0 |
| 180 | Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca | 28 | 187,947 | 47,500 | 149,954 | 0 | 652,934 | 1,038,334 |
| | Grantet Qeveritare | 28 | 187,947 | 47,500 | 149,954 | 0 | 652,934 | 1,038,334 |
| | Të hyrat vetanake | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Financim nga huamarrja | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 18013 | Infrastruktura rrugore | 5 | 33,000 | 37,000 | 149,954 | 0 | 622,934 | 842,887 |
| | Grantet Qeveritare | 5 | 33,000 | 37,000 | 149,954 | 0 | 622,934 | 842,887 |
| | Të hyrat vetanake | 0 | | 0 | 0 | 0 | | 0 |
| | Financim nga huamarrja | 0 | 0 | 0 | | | | |
| 18417 | Zjarrfikësit dhe inspektimet | 23 | 154,947 | 10,500 | 0 | 0 | 30,000 | 195,447 |
| | Grantet Qeveritare | 23 | 154,947 | 10,500 | 0 | 0 | 30,000 | 195,447 |

| | | | | | | | | | | |
|--------------|--|--|--|-----------|----------------|---------------|----------|----------------|------------------|------------------|
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 195 | | | Zyra komunale për komunitete dhe kthim | 1 | 5,914 | 5,000 | 0 | 0 | 0 | 10,914 |
| | | | Grantet Qeveritare | 1 | 5,914 | 5,000 | | | | 10,914 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | 0 | | | | | |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | 0 | | | | | |
| 470 | | | Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural | 21 | 108,574 | 21,800 | 0 | 120,000 | 0 | 250,374 |
| | | | Grantet Qeveritare | 21 | 108,574 | 21,800 | 0 | 0 | 0 | 130,374 |
| | | | Të hyrat vetanake | | 0 | 0 | 0 | 120,000 | 0 | 120,000 |
| | | | Financim nga huamarrja | | | | | | | 0 |
| 47013 | | | Bujqësia | 11 | 57,574 | 12,000 | 0 | 120,000 | 0 | 189,574 |
| | | | Grantet Qeveritare | 11 | 57,574 | 12,000 | 0 | 0 | 0 | 69,574 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | | 120,000 | 0 | |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | |
| 47053 | | | Zhvillimi dhe inspektimi bujqësor | 10 | 51,000 | 9,800 | 0 | 0 | 0 | 60,800 |
| | | | Grantet Qeveritare | 10 | 51,000 | 9,800 | 0 | 0 | 0 | 60,800 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | 0 |
| 650 | | | Kadastra dhe gjeodezia | 9 | 54,195 | 8,000 | 0 | 0 | 0 | 62,195 |
| | | | Grantet Qeveritare | 9 | 54,195 | 8,000 | 0 | 0 | 0 | 62,195 |
| | | | Të hyrat vetanake | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | | | | | | | |
| 65065 | | | Shërbimet kadastrale | 9 | 54,195 | 8,000 | 0 | 0 | 0 | 62,195 |
| | | | Grantet Qeveritare | 9 | 54,195 | 8,000 | | | | 62,195 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | 0 |
| 660 | | | Planifikimi urban dhe mjedisi | 8 | 48,954 | 4,500 | 0 | 0 | 2,678,130 | 2,731,584 |
| | | | Grantet Qeveritare | 8 | 48,954 | 4,500 | 0 | 0 | 2,578,130 | 2,631,584 |
| | | | Të hyrat vetanake | | 0 | 0 | 0 | 0 | 100,000 | 100,000 |
| | | | Financim nga huamarrja | | | | | | | |
| 66370 | | | Planifikimi urban dhe inspeksioni | 8 | 48,954 | 4,500 | 0 | 0 | 2,678,130 | 2,731,584 |
| | | | Grantet Qeveritare | 8 | 48,954 | 4,500 | 0 | 0 | 2,578,130 | 2,631,584 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | | | 100,000 | 100,000 |

| | | | | | | | | | | |
|--------------|--|--|--|--------------|------------------|----------------|----------------|---------------|----------------|------------------|
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | 0 |
| 730 | | | Shëndetësia dhe mirëqenia sociale | 128 | 915,231 | 389,604 | 50,500 | 0 | 525,126 | 1,880,461 |
| | | | Grantet Qeveritare | 128 | 882,231 | 258,533 | 50,500 | 0 | 503,126 | 1,694,390 |
| | | | Të hyrat vetanake | | 33,000 | 0 | 0 | 0 | 22,000 | 55,000 |
| | | | Financim nga huamarrja | | 0 | 131,071 | | | | 131,071 |
| 73022 | | | Administrata | 6 | 56,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 56,000 |
| | | | Grantet Qeveritare | 6 | 56,000 | 0 | | | | 56,000 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | 0 | | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | 0 |
| 73800 | | | Shërbimet e shëndetësisë primare | 122 | 859,231 | 389,604 | 50,500 | 0 | 525,126 | 1,824,461 |
| | | | Grantet Qeveritare | 122 | 826,231 | 258,533 | 50,500 | | 503,126 | 1,638,390 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | 33,000 | | | | 22,000 | 55,000 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | 131,071 | | | | 131,071 |
| 75560 | | | Shërbimet sociale | 11 | 63,436 | 43,000 | 0 | 0 | 0 | 106,436 |
| | | | Grantet Qeveritare | 11 | 63,436 | 43,000 | 0 | 0 | 0 | 106,436 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | |
| 850 | | | Kultura, rinia dhe sportet | 8 | 63,436 | 174,760 | 0 | 70,000 | 0 | 308,196 |
| | | | Grantet Qeveritare | 8 | 63,436 | 174,760 | 0 | 0 | 0 | 238,196 |
| | | | Të hyrat vetanake | | 0 | 0 | 0 | 70,000 | 0 | 70,000 |
| | | | Financim nga huamarrja | | 0 | 0 | | 0 | | |
| 85013 | | | Shërbimet kulturore | 6 | 52,736 | 40,000 | 0 | 70,000 | 0 | 162,736 |
| | | | Grantet Qeveritare | 6 | 52,736 | 40,000 | | 0 | | 92,736 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | | 70,000 | | 70,000 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | 0 |
| 85053 | | | Përkrahja e Rinis | 1 | 5,500 | 53,760 | 0 | 0 | 0 | 59,260 |
| | | | Grantet Qeveritare | 1 | 5,500 | 53,760 | | | | 59,260 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | 0 | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | 0 | | | | 0 |
| 85093 | | | Sporti dhe rekreacioni | 1 | 5,200 | 81,000 | 0 | 0 | 0 | 86,200 |
| | | | Grantet Qeveritare | 1 | 5,200 | 81,000 | | 0 | | 86,200 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | 0 | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | 0 | | | | 0 |
| 920 | | | Arsimi dhe shkenca | 1,000 | 6,278,707 | 161,460 | 104,546 | 50,000 | 63,258 | 6,657,971 |
| | | | Grantet Qeveritare | 1,000 | 6,278,707 | 113,529 | 104,546 | 0 | 51,304 | 6,548,086 |

| | | | | | | | | | | |
|--------------|--|--|--|------------|------------------|---------------|---------------|----------|---------------|------------------|
| | | | Të hyrat vetanake | | 0 | 30,000 | 0 | 50,000 | 0 | 80,000 |
| | | | Financim nga huamarrja | | 0 | 17,931 | 0 | 0 | 11,954 | 29,885 |
| 92065 | | | Administrata | 6 | 42,792 | 0 | 0 | 0 | 0 | 42,792 |
| | | | Grantet Qeveritare | 6 | 42,792 | 0 | 0 | | | 42,792 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | | | | | 0 |
| 92450 | | | Arsimi parashkollor dhe qerdhet | 61 | 358,800 | 68,526 | 4,500 | 0 | 0 | 431,826 |
| | | | Grantet Qeveritare | 61 | 358,800 | 38,526 | 4,500 | | | 401,826 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | 30,000 | | | | 30,000 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | 0 | | | | 0 |
| 93360 | | | Arsimi fillor | 802 | 4,884,775 | 64,597 | 72,033 | 0 | 63,258 | 5,084,663 |
| | | | Grantet Qeveritare | 802 | 4,884,775 | 46,666 | 72,033 | | 51,304 | 5,054,778 |
| | | | Të hyrat vetanake | 0 | | | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | 0 | | 17,931 | | | 11,954 | 29,885 |
| 94560 | | | Arsimi i mesëm | 131 | 992,340 | 28,337 | 28,013 | 0 | 0 | 1,048,690 |
| | | | Grantet Qeveritare | 131 | 992,340 | 28,337 | 28,013 | 0 | 0 | 1,048,690 |
| | | | Të hyrat vetanake | | | | | | | 0 |
| | | | Financim nga huamarrja | | | | | | | 0 |

Katër kategoritë e para të shpenzimeve njihen si shpenzime operative të cilat me Qarkore Buxhetore të MEF-it janë të limituara, për dallim nga kategoria e pestë e cila s'do të këtë kufizime. Maksimumi i rritjes së lejueshme të shpenzimeve operative do të jetë i kufizuar dhe i përcaktuar me Qarkoren e dytë Buxhetore të MEF-it e cila pritet të shpërndahe nga mesi i korrikut.


Numri i të punësuarve me Buxhetin Komunal 2018 është i lejueshëm deri në **1.287** punëtorë. Ndersa per vitin 2019 caktohet me kufijt buxhetor ne Qarkoren buxhetore 2019/2. Shpenzimet operative edhe gjatë viteve në vijim do të kontrollohen në mënyrë rigoroze me tendencë të zvogëlimit të tyre në at mënyrë që shpenzimet për investime kapitale të shënojnë rritje progressive, nga viti në vit.

Si tani ashtu edhe në të ardhmen do ti kushtohet kujdes implementimit më efektiv të shpenzimeve kapitale publike dhe shfrytëzimit të iniciativave të llojit të partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat dhe ky do të jetë synim kryesor për vitet në vijim.

Ndarja sektoriale e shpenzimeve në vitin 2019 planifikohet si vijon:

- ❖ Granti i përgjithshëm duke u bazuar në burimin e të hyrave, planifikohet të marr pjesë në buxhet me shpenzime për **35.40%**
- ❖ Granti i arsimit planifikohet të marr pjesë në buxhet me shpenzime me **45.64%**
- ❖ Huamarrja për arsim **0.21%**
- ❖ Granti i shëndetësisë dhe i mirëqenjes sociale planifikohet që të marr pjesë në buxhet me shpenzime për **11.42%**
- ❖ Huamarrja për shendetësi **0.91%**
- ❖ Të Hyrat Vetanake **6.42%**.

Buxheti për 2019



Në Strategjinë Fiskale 2019-2021, në Sektorin e Arsimet, kemi një rritje të vogël me krahasim me vitin paraprak, por kjo është faza fillestare e buxhetimit. Komuna në procedurat e buxhetimit do të analizoj mirë këtë buxhet dhe nëse nuk ka Grantë shtesë nga Qeveria e Kosovës, atëherë nevojat e financimit do të përmbushen nga Granti i përgjithshëm i komunës. Procesi buxhetor do të shërben si mjet për ofrimin e politikave të drejta financiare me prioritet të arsyeshme, në interes të qytetarëve të Komunës së Malishevës.

6.STRATEGJIA ZHVILLIMORE PËR SEKTORËT KOMUNAL

Komuna ka të përgatitur dhe të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal 2015-2023⁺ dhe në të është cekur vizioni për të ardhmen :*“Komuna e Malishevës do të këtë infrastrukturë të përmirësuar fizike dhe mjedis të mbrojtur natyror, ambient të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve, bujqësi intensive, rritje të punësimit, ngritje të nivelit të arsimet dhe të edukimit sipas nevojave të tregut, shërbime cilësore publike, shëndetësore dhe administratë lokale më efektive”*.

Komuna në tri vitet e ardhshme do të këtë këto objektive për realizim dhe njëherit do të financoj tërësisht apo pjesërisht ato si vijon:

Objektivat:

- Shtimi i efikasitetit në punë që ndikon në zhvillimin ekonomik:
 - përmirësimi i kushteve për shërbime publike,
 - përmirësimi i efikasitetit në shpenzimet e parave publike,
 - shfrytëzimi maksimal i burimeve të mundshme,
 - kryerja e punëve me kohë dhe në mënyrë të duhur.

- Rritja e shpejtë e të ardhurave :
 - shkalla më e lartë e arkëtimit të tarifave dhe ngarkesave
 - insistimi në zgjerimin e fushave kryesore për të hyrat,
 - ngarkesa të reduktuara me tarifa të zgjeruara,

- Sigurimi i disiplinës financiare :
 - ✓ pajtueshmëri me politiken financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet ,
 - ✓ ekzistenca e kontroleve interne,
 - ✓ transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik
 - ✓ analiza e shpenzimeve ,
 - ✓ evidencë e duhur financiare dhe kontabël,
 - ✓ inventarizim i duhur dhe menaxhim i pronës,
 - ✓ përmirësim i politikës së prokurimit dhe iprocedurav.
 - ✓ forumi ekonomik
 - ✓ zhvillimi i strategjisë komunale për promovim ekonomik,
 - ✓ krijimi i kushteve për interesimet e investitorëve ,
 - ✓ nxitja e mundësive bankare / mikro kredive ,
 - ✓ plani për zhvillimin e viseve rurale,
 - ✓ marketingu i potencialit zhvillimor të komunës për mesë zyrës së biznesit
 - ✓ vendosja e forumit ekonomik.

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:

- Përgatitja e planit dhe roporteve të punës 2019-2021,
- Zbatimi i planit zhvillimor komunal dhe urban ,
- Përgatitja e planit urbanistik,
- Përgatitja e kornizës afatmesme të shpenzimeve 2019-2021,
- Përmirësimi i mbledhjes thelbësore të të dhënave dhe përdorimi,
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe obligimeve komunale,

- Kujdesi ndaj palës (menaxhimi i mirë i zyrës pritëse),
- Zbatimi më përpikëri i ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve në fuqi,
- Vendosja e pajisjeve për tërë stafin,

7.MENAXHIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PROJEKTEVE

Për faktin së Komuna e Malishevës, hynë në radhën e komunave më të pa zhvilluara, kërkohet një financim shtesë ose nga Qeveria e Kosovës ose nga donatorët e jashtëm në at mënyrë që sa do pak të përmisohet infrastruktura në nivel komunal.

Tani, komuna përballet me një dinamik më të shpejtë të zhvillimit ekonomik e sidomos në sektorin privat të cilit sektor duhet ti sigurohen kushte të mirëfillta dhe të bazuara në ligje dhe mos të jen të rrezikuara investimet në këtë sektor.

Komuna me organet– administratën, duhet mbështetur në forma të ndryshme e sidomos duhet mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme që do të ndikojn në zhvillimin ekonomik të komunës dhe në zvogëlimin e papunësisë.

Në zvogëlimin e pa punësisë në komunën tonë do të ndikojn edhe investimet e punëtorëve tan të cilët janë të punësuar në diasporë. Paratë e dërguara nga diaspora janë një prej burimeve kryesore të hyrave për një numër të madh të familjeve, edhe pse ka një rënje nga e kaluara. Paratë e dërguara nga diaspora kanë ndikuar shumë në rindërtimin e shtëpive të banimit, të ekonomive familjare, gjë e cila mund të shihet ku do në teritorin e komunës.

Me krijimin e kushteve më të favorshme dhe përkrahjen teknike që do ta japi zyra për këshilla për biznes, ndoshta do të intensifikoj interesimin e diasporës sonë për investime në Malishevë.

Ndarja e grantit të përgjithshëm nga ana e MEF-së është bërë për komunën tonë në bazë të numrit të ri të regjistrimit të popullsisë (viti 2011) për 54.613 banor.

Në bazë të disa vlerësimeve supozohet së në një familje mesatarisht jetojnë prej 5 deri në 9 anëtarë në një familje. Sa i për ketë të hyrave familjare mesatar në komunë nuk egëzistojnë shënimet e sakta por edhe këtu vlerësohet së mesatarja e të hyrave vjetore për familje është shumë e vogël.

Ne kemi nevojë për të vendosur një sistem të fuqishëm të menaxhimit të informatave pasi që informatat janë vitale për marrjen e vendimeve. Instalimi i pajisjeve moderne teknologjike, pastaj trajnimi i punëtorëve si dhe përpunimi i të dhënave në baza të rregullta janë aktivitetet kyçe të cilat kërkojnë vëmendje urgjente edhe në këtë periudhë.

Tabela 5. Buxheti sipas kategorive Buxhetore

| Kategoritë buxhetore | | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|----------------------|-----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| 1. | Pagat dhe mëditje | 8.090.144 | 8.272.507 | 8.272.507 | 8.272.507 |
| 2. | Mallrat dhe shërbime | 1.250.002 | 1.250.002 | 1.250.002 | 1.250.002 |
| 3. | Shpenzimet komunale | 305.000 | 305.000 | 305.000 | 305.000 |
| 4 | Subvencione dhe transfere | 65.767 | 276.130 | 276.767 | 276.767 |
| 5. | Kapitale | 4.392.811 | 4.294.341 | 4.677.172 | 5.177.313 |
| | TOTALI: | 14.103.724 | 14.347.979 | 14.781.448 | 15.281.589 |
| | Nr. i të punësuarve: | 1.287 | 1.287 | 1.287 | 1.287 |

8. PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)

Projektet e regjistruara në sistemin PIP-it, janë të përgatitura nga drejtoratet-programet, të bazuara në nevojat e qytetarëve të komunës së Malishevës dhe subjekteve tjerë. Këto projekte dhe projektet tjera të propozuar, gjatë proceseve buxhetore do të analizohen, shqyrtohen dhe në fund do të aprovohen në kuvend në bazë të mundësisë reale buxhetore që ka komuna për financim gjatë periudhës 2019-2021.

Lista perfundimtare e projekteve ne fund të procesit buxhetor do të aprovohet në Kuvend dhe dhe do të jet pjesë perberëse e ketij dokumenti.

9. KORNIZA E PERFORMANCES SË SHPENZIMEVE TË NJËSIVE BUXHETORE

Zyra e kryetarit

Deklarata e misionit : Është posti më i lartë politik në Komunë

Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj; Udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe Administratën e saj si dhe mbikqyr administrimin financiar të Komunës; Ushtron të gjitha

kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo Komiteteve të tij; Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës; Emëron apo shkarkon zëvendësin e tij; Emëron dhe shkarkon drejtorët e Drejtorive të Administratës komunale; Organizon punën dhe drejton politikën e Komunës; Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; Propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, Propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar; Raporton para kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës; dhe mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti çënon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve, si dhe kryen edhe aktivitete tjera të parapara me statutin e Komunës.

Deklarata e Vizionit: Zhvillimi komunal, ngritja e te hyrave komunale, ulja e shpenzimeve .ngritja e investimeve kapitale ,realizimi i projekteve 2017-2018... ,profesionalizimi i administratës.

Deklarata e Qëllimit : Arritja e realizimit te objektivave dhe programit të punës.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|----------------------|---------------------------|---------------|---------------|---------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 40.584 | 40.584 | 40.585 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 15.000 | 15.000 | 15.000 |
| 3. | Shpenzime komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | 36.130 | 36.130 | 36.130 |
| 5. | Kapitale | | | |

| | | | | |
|--|-------------------------------|---------------|---------------|---------------|
| | Totali: | 91.984 | 91.984 | 91.984 |
| | Numri i të punësuarve: | 3 | 3 | 3 |

| |
|--|
| Kuantitative: |
| Mbledhje me publikun : |
| Në funksion të pjesëmarrjes në vendimmarrje, përmes propozimeve përkatëse, shqyrtohen çështje në interes të përgjithshëm të qytetarëve, për kategori të caktuara të qytetarëve, fshatrave apo lagjeve. |
| Dëgjimet buxhetore për përgatitjen e projektbuxhetit të Komunës |
| Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi: |
| Mban mbledhje të rregullta mujore dhe shqyrton çështjet për sigurinë e bashkësive në Komunë. |
| Takimet me qytetarë për çështje të sigurisë në Komunë |
| Grupi komunal për kthim |
| Kualitative: |
| Kjo zyrë angazhohet në zbatimin dhe avancimin e akteve nënligjore të miratuara në Kuvend të komunës, politikave të Komunës në të gjitha sferat e jetës në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të nivelit lokal. |
| Identifikon mënyrat më efektive të realizimit të Strategjisë afatmesme të zhvillimit ekonomik të komunës dhe avancimin e mirëqenies sociale të qytetarëve në përgjithësi. |
| Mbikëqyr dhe garanton respektim të rregullave në shpenzimet e buxhetit të Komunës mbi bazën e projekteve të miratuara në Kuvend |

e që prekin standardin e jetës të qytetarëve .

Garanton ndarje të drejtë të buxhetit.

Garanton barazinë gjinore, mundësitë e barabarta, respektimin e lirive e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve.

Zyra e kuvendit të komunës

Deklarata e misionit : Kuvendi është organi më i lartë në Komunë ,kryesuesi i Kuvendit thërret dhe udhëheq me punët e mbledhjeve të Kuvendit , kryeson Komitetin për Politikë dhe Financa, mbikëqyr punët e komiteteve obligative dhe komiteteve e komisioneve joobligative të ngritura nga Kuvendi.

Miraton buxhetin dhe planet investive, aktet e përgjithshme dhe aktet tjera në kompetencë të nivelit lokal.

Deklarata e Vizionit: Ushtrimi dhe përmbushja sa më efikase e kompetencave ligjore dhe nënligjore në interes të Komunës dhe qytetarëve në përgjithësi.

Deklarata e Qëllimit : Arritja e realizimit të planit të punës të Kuvendit të Komunës.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|--------------------------------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 119.337 | 119.337 | 119.337 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 50.000 | 50.000 | 50.000 |
| 3. | Shpenzime komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | | | |
| 5. | Kapitale | 10.000 | 0 | 0 |
| | Totali: | 179.337 | 169.337 | 169.337 |
| Numri i të punësuarve : | | 3+31 | 3+31 | 3+31 |

| |
|---|
| Kuantitative: |
| <p>1. Kuvendi :</p> <p>- Mundësi për mbajtjen e mbledhjeve urgjente</p> <p>Shqyrton të gjitha çështjet të cilat ia parashtron Komiteti për Politikë dhe Financa, përkatësisht çështjet të cilat mbi bazën e përgjegjësisë është i obliguar t'i propozojë Ekzekutivi i Komunës</p> |
| <p>Kryesuesi i Kuvendit:</p> <p>Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit të komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, mbikëqyrë punët e komiteteve tjera obligative dhe joobligative të Kuvendit dhe në vijimësi kryen punët e përditshme në kompetencë të kryesuesit të Kuvendit,</p> |
| <p>Komiteti për Politikë dhe Financa :</p> <p>Shqyrton çështjet të cilat i propozohen nga Ekzekutivi i komunës dhe i propozon Kuvendit për miratim me rekomandime konkrete.</p> <p>Kryen edhe punë dhe përgjegjësi tjera të cilat i delegohen nga Kuvendi i komunës.</p> |
| <p>Komiteti për komunitete:</p> <p>Mban mbledhje të rregullta dhe shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve në të gjitha sferat e jetës.</p> |
| <p>Komisioni për shëndetësi dhe politikë sociale:</p> <p>Mban mbledhje sipas nevojës dhe shqyrton çështje nga lëmia e shëndetësisë dhe politikës sociale, kërkon informacione nga drejtoria përkatëse dhe për çështje të cilat vlerëson se janë në interes kërkon përgatitjen e materialeve përkatësisht bën propozime konkrete për</p> |

| |
|---|
| shqyrtim në Kuvend të komunës. |
| <p>Komisioni për arsim , kulturë, rini dhe sport:</p> <p>Mban mbledhje sipas nevojës dhe shqyrton çështje nga lëmia e arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit, kërkon informacione nga drejtoria përkatëse dhe për çështje të cilat vlerëson se janë në interes kërkon përgatitjen e materialeve përkatësisht bën propozime konkrete për shqyrtim në Kuvend të Komunës</p> |
| <p>Komisioni për planifikim, urbanizëm dhe pronë :</p> <p>Mban mbledhje sipas nevojës dhe shqyrton çështje nga lëmia e planifikimit,urbanizmit dhe pronës,kërkon informacione nga drejtoritë përkatëse dhe për çështje të cilat vlerëson se janë në interes kërkon përgatitjen e materialeve përkatësisht bënë propozime konkrete për shqyrtim në Kuvend të komunës .</p> |
| Kualitative: |

Drejtoria për administrat të përgjithshme

Deklarata e misionit : Kryen detyrat që i jepen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale , Statut dhe Rregulloren e Punës të Komunës; ndihmon kryetarin, kuvendin dhe komitetet obligative.

Bënë organizimin e logjistikës që përfshin përgjegjësit si :transportin (veturat zyrtare) , depon, arkivin postën , menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale, shërbimin e sigurisë , mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative , mirëmbajtjen e ueb aplikacionit dhe futjen e informatave në të, organizimi dhe koordinimi i suksesshëm i punëve dhe aktiviteteve për menaxhim të burimeve njerëzore , zbatimin e ligjshmërisë , efikasitetin dhe azhuretetin në punë të organeve të administratës , ofrimin e shërbimeve për qytetarë , siç janë shërbimet e ofiqaris , ankesat e qytetarëve në procesin administrativ , shërbimet e përbashkëta , organizimin e suksesshëm të të gjitha punëve dhe aktiviteteve të bëra në përgjegjësi te kësaj drejtorie .

Deklarata e Vizionit: Vizioni në drejtorinë për Administratë dhe Personel është me një administratë efikase , transparente dhe moderne e cila do t'i ofroj shërbime më të mira për qytetarët , krijimin e kushteve për ngritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve të komunës.

Deklarata e Qëllimit: Një administratë lokale të suksesshme, efikase profesionale me një azhuritë në kryerjen e punëve dhe shërbimeve, disiplinë në punë, por edhe kushte më të mira për kuadro profesionale dhe hapësire më të mirë për punë.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|-------------------------------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 248.695 | 248.695 | 248.695 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 289.609 | 289.609 | 289.609 |
| 3. | Shpenzime komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | | | |
| 4. | Kapitale | | | |
| | Totali: | 538.302 | 538.302 | 538.302 |
| Numri i të punësuarve: | | 43 | 43 | 43 |

Kuantitative:

| |
|----------------------------|
| 1. Çertifikata të lindjes |
| 2. Çertifikata të martesës |
| 3. Çertifikata të vdekjes |
| 4. Statut martesor |
| 5. Çertifikata Jete |

| |
|---|
| 6. Çertifikata familjare |
| 7. Çertifikat banimi |
| 8. Çertifikata e shtetesis |
| Kualitative: |
| 1. Me rregullimin e hapësirave të punës , hapjen e zyrave të vendit në teren , furnizimin e të gjitha zyrave e sidomos zyrave të vendit me vula dhe aparatura të tjera të nevojshme, kryerja e punëve më e shpejt e palëve në teren dhe krimi i shpenzimeve më të vogla, shtimi i efikasitetit të punës, zbatimi i ligjit, akteve nënligjore dhe rregulloreve, mbikëqyrja dhe respektimi i shpenzimeve buxhetore të komunës dhe respektimi i parimeve të barazisë gjinore etnike dhe respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut do të ndikojnë drejtpërdrejt në ndryshimet kualitative të kryerjes së punëve në këtë drejtori . |

Drejtoria për buxhet dhe financa

Deklarata e misionit : bënë menaxhimin e buxhetit dhe financave të komunës, I siguron drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon lidshpin komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e komunës.

Deklarata e Vizionit : Drejtoria për buxhet dhe financa është orientuar nga biznesi në mënyr që të krijoj kushte për një rreth atraktiv dhe të favorshëm për biznesin lokal duke ofruar një spektër te gjere te mundësive për punësim si ne sektorin privat dhe publik ,ne sektorët e shërbimit ,bujqësisë dhe prodhimit.

Deklarata e Qëllimit: - Te transformohet drejtoria ne funksion qe te jete ma e përgjegjshme ndaj qytetarëve dhe bizneseve;

- Te siguroj ofertën e duhur te shërbimeve për biznes dhe kushte te tjera për te mbështetur zhvillimin e bizneseve te reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese ,

- Te siguroj dhe nxis përmirësimin e infrastrukturës së ndërtuar dhe asaj njerëzore të nevojshme për rritjen e biznesit
- Te tërheq vazhdimisht projekte të reja investive nga sektori privat ,publik duke tërhequr edhe donator nga komuniteti. Qëllimi i drejtorisë është menagjimi efikas i fondeve , inkasimi sa më i madhe i të hyrave vetanake dhe realizimi i buxhetit të parashikuar.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|-------------------------------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 143.689 | 143.689 | 143.689 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 57.700 | 57.700 | 57.700 |
| 4. | Shpenzime komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | | | |
| 5. | Kapitale | 324.893 | 324.893 | 324.893 |
| | Totali: | 526.282 | 526.282 | 526.282 |
| Numri i të punësuarve: | | 24 | 24 | 24 |

Kuantitative :

1.Drejtoria për Buxhet dhe Financa veprimtarin e vet e zhvillon në bazë të kompetencave të përcaktuara me rregullore dhe ligjet e aprovuara nga Kuvendi i Kosovës,rregulloret e aprovuara nga KK dhe në bazë të instruksioneve financiare të aprovuara nga MF dhe atë në disa sektor :

- sektorin e buxhetit,

- sektorin e thesarit,

- sektorin e tatimit në prone,

- sektori për Planifikim dhe Zhvillim ,

- Në sektorin e buxhetit kryhen këto punë :

- Përgatitja e të dhënave për hartimin e buxhetit ,

- Përgatitja e Kornizës Afat Mesme Buxhetore (KAB)

- Përgatitja e projekt buxhetit për vitet 2019-2021

- Planifikimin e projekteve kapitale për vitet 2019-2021

- Raportin e shpenzimeve për ndarjen e drejt financiare në 4 periudha tre mujore .

Në sektorin e thesarit kryhen këto punë :

-Në këtë sektor bëhet menagjimi I fondeve dhe monitorimi i sistemit dhe proceseve të ekzekutimit të buxhetit

- regjistrimi i të gjitha transaksioneve financiare të aprovuara nga MF

- përgatit raporte finale periodike dhe vjetore

- bënë shkresa mujore për alokimin e mjeteve vetanake

-përgatit raporte dhe bënë barazime me furnitor për pagesat e bëra.

Nxjerr aktvendime për tarifën komunale vjetore.

Zyrtarët e këtij sektori çdo ditë marrin raporte nga banka për të hyrat komunale ditore për të gjitha llogarit e Komunës.

-Përgatit raporte mujore mbi të hyrat vetanake të komunës,

- Bënë zotimin e mj.në sist.e Frebalance për shpenz.e planif.

Në sektorin e tatimit në prone :

- Nxirren fatura tatimore në vit
- Bëhet shpërndarja e faturave të cekura,
- Bëhet regj. i pronave –objekteve të reja
- Bëhet përmirësimi i faturave në bazë të ankesave të palëve,
- Përgatiten dhe shpërndahen vërejtje për mospagimin e tatimit në afatin e caktuar,
- Bëhet lëshimi i vërtetimeve për dëshmitë e pagesës së tatimit,
- Nxirren vendime mbi transferin e pronës.

Kualitative:

1. Inkasimi i të hyrave vetanake në kuadër të drejtorisë për Buxhet dhe Financa si : tatimi në prone , tarifa komunale, të hyrat nga urbanizmi , të hyrat nga katastri , të hyrat nga administrata dhe të hyrat tjera ndikon pozitivisht në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të komunës sonë , sepse mjetet e arkëtuara nga këto tatime direkt shkojnë në ngritjen e infrastrukturës si asfaltimi i rrugëve të qytetit dhe fshatrave ,ndërtimi I ujësjellësit dhe kanalizimit ,ngritjen e shkollave , ngritjen e ambullantave ,meremetimi i rr. rurale dhe projekteve të tjera që ndikon pozitivisht në zhvillimin ekon. të Komunës dhe zvogëlimin e migrimit të popullsisë nga fshati në qytet . Këto mjete kanë destinimin e caktuar për investime kapitale . Realizimi i tyre ndikon drejt për së drejti në realizimin e projekteve prioritare për komunën.

Drejtoria për gjeodezi dhe kadastër

Deklarata e misionit : Administrata është përgjegjëse për të mbajtur marrëdhënie të ngushta me qeverinë qendrore-Ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencionin kadastral të Kosovës. Të menaxhojë çështjet buxhetore dhe financiare të drejtorisë dhe stafit, të nxjerr politika dhe rregulla për menaxhimin e drejtorisë.

| |
|---|
| Deklarata e Vizionit : Zyra për kadastrë është përgjegjëse të kujdeset dhe për mirëmbajtjen e të gjithë regjistrave kadastral, ku përfshihet e gjithë palujatshmëria komunale. |
| Deklarata e Qëllimit : Qëllimi i kësaj drejtorie është të marrë vendime duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve; matjet, incizimet, ndarjet (në parcela), nëndarjet e pronave të tokës. |

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|-------------------------------|---------------------------|---------------|---------------|---------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 54.195 | 54.195 | 54.195 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 8.000 | 8.000 | 8.000 |
| 4. | Shpenzimet komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | | | |
| 5. | Kapitale | | | |
| | Totali: | 62.195 | 62.195 | 62.195 |
| Numri i të punësuarve: | | 9 | 9 | 9 |

| |
|---------------------------------------|
| Kuantitative: |
| 1. Fletë poseduese |
| -Kopje plani |
| -Aktvendime mbi regjistrimin e pronës |
| -Kërkesa për teren |

- Kontrata mbi transaksionin
- Aktvendime mbi caktimin e hipotekës
- Certifikata mbi gjendjen ekonomike
- Aktvendime mbi marrjen e pronës së uzurpuar
- Konstatimi i gjendjes faktike në teren
- Aktvendime mbi eksproprijimin
- Vërtetime të ndryshme mbi pronën
- Ripërkufizim i pronës shoqërore
- Konkluzione mbi ekzekutimin e vendimeve
- Kallëzime penale ndaj uzurpuesve të pronës publike
- Kontrata mbi dhënien për shfrytëzim përkohshëm të pronës publike

Kualitative:

Për t'u kryer në mënyrë kualitative punët dhe detyrat e planifikuara për vitet e ardhshme 2019-2020 dhe 2021 do të ishte i nevojshëm që buxheti i kërkuar më lartë të realizohet në të kundërtën do të mungojnë rezultatet e dëshiruara gjithashtu rezulton edhe me mungesën e kuantitetit për vendosje.

Drejtoria e inspeksionit

Deklarata e misionit : Siguron mbrojtjen e qytetarit në cilësinë e tij si konsumator dhe shfrytëzues i shërbimeve, dhe këtë e bën duke inspektuar zbatimin e ligjeve , rregulloreve , udhëzimeve , dhe dispozitave të

| |
|--|
| tjera. |
| Deklarata e Vizionit : Sigurimi i mjedisit ku sundon e drejta e bazuar ne ligj, efikasitet dhe cilësi ne shërbim te qytetarit. |
| Deklarata e Qëllimit : Përmes inspektimeve te siguroj treg te lire, artikuj te shëndetshëm, ambient te pastër, kushte higjieno-sanitare, mbrojtje te ujërave dhe pyjeve, mos cenim të hapësirave publike dhe siguri e zbatim te planeve hapësinore dhe urbane dhe standarde ne ndërtimtari. |

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|----------------------|-------------------------------|---------------|---------------|---------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 51.000 | 51.000 | 51.000 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 9.800 | 9.800 | 9.800 |
| 4. | Shpenzime komunale | | | |
| 4. | Transfero dhe subvencione | | | |
| 5 | Kapitale | | | |
| | Totali: | 60.800 | 60.800 | 60.800 |
| | Numri i të punësuarve: | 10 | 10 | 10 |

| Kuantitative: |
|---|
| <p>1. Drejtoria për Inspeksion kryen këto punë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kontrollin e kualitetit te ushqimit; - kontrolli kualitativ i ujit te pijes; -mbikëqyrja e shëndetit publik dhe higjienën e objekteve; -mbikëqyrja e zhvillimit te tregtisë; |

-evidentimi dhe qarkullimi i mallit;

- mbikëqyrja e cilësisë së derivateve dhe mallrave të tjera;

-implementimi i rregulloreve për orar të punës;

- kontrolli dhe mbikëqyrja e fondit të kafshëve dhe blegtorisë në përgjithësi;

- mbikëqyrja e masave shëndetësore-vaksinimi i kafshëve;

- kontrolli i qarkullimit të kafshëve;

-inspektimi i kulturave bujqësore;

Mbikëqyrja e qarkullimit dhe cilësisë së repromaterialit bujqësor dhe masat tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë;

-evidentimi dhe mbikëqyrja e ndërtimit të objekteve;

- zbatimi i cilësisë dhe zbatimi i planeve urbanistike dhe hapësinore;

-zbatimi i rregullave për transport si dhe sigurimi i orareve të transportit publik dhe privat;

-mbikëqyrja e sipërfaqeve publike, shërbimet publike të ujësjellësit, kanalizimet, rrymës elektrike;

-mbrojtja e pyjeve, monitorimi dhe mbikëqyrja e rojeve të pyllit

Kualitative:

1. Masat e ndërmarrura do të ndikojnë në ruajtjen e Planit Urbanistik, rritjen e inkasimit të të hyrave vetanake, kualitetin e ushqimit, qarkullimin e lirë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike dhe të gjelbëruara, pastrimin e qytetit, si dhe ruajtjen e ambientit.

Drejtoria e urbanizmit

Deklarata e misionit : Drejtoria e urbanizmit, si mision kryesor ka :

- Përfundimin e planit zhvillimor komunal;
- Hartimin e planeve rregulluese për disa zona të qytetit.
- Avancimi i mëtejshëm i rregullimit të infrastrukturës rrugore;
- Përfundimin e Rregullimit të shtratit të lumit Mirusha dhe hapësirave përgjatë brigjeve të tij;
- Mirëmbajtja e parqeve dhe shtimi i hapësirave të gjelbëruara si dhe eliminimi i deponive të egra;

Deklarata e Vizionit: Me planifikim të mirë hapësinorë dhe urbanistik, me infrastrukturë të avancuar , me një mjedis të pastër dhe shtimin e hapësirave të gjelbëruara .

Deklarata e Qëllimit : Rregullimi i infrastrukturës rrugore, zhvillimi urban dhe hapësinor dhe mbrojtja e mjedisit.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|-------------------------------|---------------------------|------------------|------------------|------------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 48.954 | 48.954 | 48.954 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 4.500 | 4.500 | 4.500 |
| 3. | Shpenzimet komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | | | |
| 5. | Kapitale | 2.678.130 | 2.678.130 | 2.678.130 |
| | Totali: | 2.731.584 | 2.731.584 | 2.731.584 |
| Numri i të punësuarve: | | 8 | 8 | 8 |

Kuantitative:

1. Konkluzë

2. Aktvendim për Leje Urbanistike

3. Aktvendime për Leje Ndërtimi, Rikonsruimi, Adaptimi, meremetim
4. Aktvendime për Mbikëqyrje të Objekteve
5. Aktvendime për Pranime Teknike
6. Aktvendime për Leje Përdorimi
7. Aktvendime për shembje të objekteve
7. Përpilimi i Rregulloreve të Drejtorisë për Urbanizëm, Shërbime Publike dhe Ambient
8. Referenca të ndryshme
9. Punimi i Projekteve Ideore
10. Paramasa dhe parallogarit për Objekte të ndryshme
11. Llogari për Kompensimin e Tokës Ndërtimore sipas Projekteve të prezantuara
12. Pëlqime për dokumentacionin dhe Programet Investivo-teknike
13. Aktvendime Për Shndërrimin e Hapësirave Banesore në Lokale Afariste
14. Hartimi e Planit Zhvillimor Komunal
15. Punimi i Planit Zhvillimor Urban
16. Punimi i Planeve Rregullative Urbane dhe Rurale
17. Kontrollimi i Programeve dhe Projekteve Investivo-Teknike
19. Leje për Legalizimin e Objekteve Ndërtimore

Kualitative:

- Planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjell dhe studion zhvillimin hapësinor brenda territorit të komunës (sipas

metodologjisë

bashkëkohore);

- Harton programe, planin zhvillimor të komunës, planin zhvillimor urban, dhe planet rregulluese urbane të vendbanimeve dhe tërësive tjera;
- Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre;
- Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij;
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore;
- Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;
- Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;
- Përcjell planifikimin urbanistik dhe projektimin dhe merret me zbatimin e tyre;
- Përgatit plane të detajuara urbanistike, projektet urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit dhe komunës;
- Harton programe, detyra projektuese, me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistko-arkitektonike.
- Përgatit dhe ofron informacione bazë dhe dokumente për përgatitjen, miratimin apo ndryshimin e planeve hapësinore, urbanistike, rregulluese dhe planeve të detajuara të qytetit dhe të komunës;
- Propozon dhe zbaton rregullativën ligjore nga lëmi i planifikimit hapësinor: Planit zhvillimor të komunës, Planit zhvillimor urban, Planit rregullues urban, si dhe rregullativën nga lëmi i ndërtimeve investive;

- Përcakton kushtet urbanistike dhe arkitektonike për hartimin e dokumentacioneve investivo-teknike, për ndërtimin e objekteve lidhur me realizimin e projekteve kryesore urbanistike dhe zgjedhjet e tyre arkitektonike;
- Propozon dhe miraton kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro-urbane në territorin e qytetit dhe komunës;
- Merret me hartimin e legjislacionit, ekspertizave analitike, veprimtarive të tjera në fushat e caktuara të planifikimit hapësinor dhe urban;

Implementimi cilësor i këtyre Planifikimeve nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për periudhën kohore 2019-2021 do të realizohet varësisht nga mundësit buxhetore të Planifikuar për këtë Drejtori.

Drejtoria për shëndetësi dhe mirqenje sociale

Deklarata e misionit : DSHMS ka për mision që banorëve të komunës t'ju sigurojë kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës dhe mirëqene sociale .Në situata te caktuara të u dalë ne ndihmë qytetarëve me statut të rëndë social ,por gjithnjë duke u bazua në mundësit buxhetore. Në bazë të kërkesave të qytetarëve me gjendje të rëndë sociale dhe në bazë të propozimeve të komiteteve të fshatrave bëhet përpilimi i listave për dhënien e ndihmës sociale familjeve me gjendje të rëndë sociale.

Gjithnjë duke identifikuar dhe vlerësuar gjendjen sociale të familjeve të propozuara .

Administrata është përgjegjëse për sigurimin e personelit të drejtorisë me udhëzime, politika dhe procedura për menaxhimin dhe implementimin e aktiviteteve, menaxhimin e buxhetit dhe të financave të drejtorisë.

Deklarata e Vizionit : Sektori i shëndetësisë ka për detyrë të kujdeset që qytetarëve t'ju ofrohen shërbime shëndetësore të nivelit parësor shëndetësor ,konform ligjit për shëndetësi si dhe të kujdeset për shëndetin e përgjithshëm publik .

Deklarata e Qëllimit : Qëllimi kryesor i sektorit të shëndetësisë është promovimi i shëndetit të popullatës ,përmirësimi i kualitetit të jetës, përparimin e përgjithshëm të mirëqenies fizike,mendore dhe sociale të qytetarëve si dhe parandalimin e sëmundjeve.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|-------------------------------|---------------------------|------------------|------------------|------------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 915.231 | 915.231 | 915.231 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 389.604 | 389.604 | 389.604 |
| 3. | Shpenzimet komunale | 50.500 | 50.500 | 50.500 |
| 4. | Subvencione dhe transfere | | | |
| 5. | Kapitale | 525.126 | 525.126 | 525.126 |
| | Totali: | 1.880.461 | 1.880.461 | 1.880.461 |
| Numri i të punësuarve: | | 128 | 128 | 128 |

Kuantitative:

-Avancimi I mjekësisë familjare
-Imunizimi I popullatës sipas kalendarit të obligueshëm
-Trajnimi dhe specializimet e kuadrit profesionist shëndetësor
-Meremetimi I infrastrukturës të disa objekteve shëndetësore.
-Furnizimi I rregullt me medikamente nga regjistri esencial i barnave
-Përcjellja e rezultateve të mostrimit të ujit të pijes
-Mbikëqyrja e artikujve ushqimor për konsumin e gjënë të popullatës
-Edukimi dhe arsimimi shëndetësor I popullatës.
-Për intervenime momentale (gjëra ushqimore,mjete higjienike,veshmbathje për familjet me gjendje jo të mirë ekonomiko-sociale).
-Ndihma një numri të shoqatave si: Shoqatën e familjeve të dëshmorëve, Invalidve civil të luftës,Handikosin,Shoqatën e të verbëve ,invalidët e punës etj.
-Luftimin e dukurive negative dhe sjelljet devijante te të rinjët si: Pirja e duhanit,alkoolit,konsumimi I substancave narkotike
-Përcjellja e problematikës të personave të moshuar ,vetmuar dhe henikepuar.

Kualitative:

-Furnizimi i rregullt me barna dhe medikamente do të lehtësoj për kujdesje më të mirë për popullatën që frekuentojnë QKMF në

Malishevë dhe QMF në teren.

-Me intervenime momentale të kategorive sociale ua lehtësojmë sadopak gjendjen e tyre ekonomiko-sociale ,

Drejtoria e arsimit

Deklarata e misionit : Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës shkollore, që siguron kushte të mira për të nxënë dhe mësimdhënie cilësore, formim cilësor të të gjithë individëve, duke inkurajuar arsimin gjatë gjithë jetës.

DA nxit të drejtën e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre për pjesëmarrje aktive në arsim, bashkëpunimin ndërmjet mësimdhënësve, prindërve, nxënësve, institucioneve arsimore, familjes dhe komunitetit në të mirë të të gjithëve.

DA angazhohet për fuqizimin e rolit të shkollave dhe të komuniteteve në qeverisjen efikase të institucioneve edukative dhe arsimore.

DA angazhohet për rritjen graduale të numrit të përfshirjes aktive të fëmijëve-nxënësve në institucionet e arsimit të detyrueshëm, e sidomos në arsimin parafillor dhe atë me nevoja të veçanta

Deklarata e Vizionit : Komuna e Malishevës me arsim të zhvilluar dhe efikas, kushte të mira për punë dhe të nxënë, mundësi të barabarta për zhvillim profesional të të gjithë individëve, arsim profesional sipas kërkesave të tregut dhe me rrejt efikas shkollor.

Deklarata e Qëllimit : DA ka për qëllim kryesor sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në të nxënë në të gjitha nivelet, ofrim të shërbimeve cilësore për nxënës, të rritur dhe nxënës me nevoja të veçanta, krijim të mundësive për zhvillim dhe aftësim profesional e metodologjik të mësimdhënësve.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|----------------------|---------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 6.278.707 | 6.278.707 | 6.278.707 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 161.460 | 161.460 | 161.460 |
| 3. | Shpenzimet komunale | 104.546 | 104.546 | 104.546 |

| | | | | |
|-------------------------------|---------------------------|------------------|------------------|------------------|
| 4. | Subvencione dhe transfere | 50.000 | 50.000 | 50.00 |
| 5. | Kapitale | 63..258 | 63.258 | 63.258 |
| | Totali: | 6.657.971 | 6.657.971 | 6.657.971 |
| Numri i të punësuarve: | | 1.000 | 1.000 | 1.000 |

Kuantitative:

- ❖ Përfshirja e nxënësve në arsimin e obligueshëm.
- ❖ Përfshirja e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë.
- ❖ Shpallja e konkursit dhe intervistimi i aplikantëve
- ❖ Plotësimi i vendeve të punës dhe pajisja me kontrat
- ❖ Zgjerimi i rrjetit të bibliotekave shkollore.
- ❖ Rritja e numrit të personelit të kualifikuar nëpër Shkolla.
- ❖ Rritja e rezultateve të suksesit të nxënësve.
- ❖ Krijimi i ambientit të përshtatshëm për punë.
- ❖ Ngritja dhe vetëdijesimi i nxënësve për mirëmbajtjen e ambientit dhe kultivimin e iniciativave të shëndosha shkollore.
- ❖ Vazhdimi i trajnimeve profesionale të mësimit të nxënësve.
- ❖ Hartimi i raporteve dhe paraqitja tabelore e suksesit të nxënësve në çdo gjysmë-vjetor.
- ❖ Planifikimi i buxhetit dhe shpërndarja e PCF2-ve e çdo njësie buxhetore.
- ❖ Planifikimi i buxhetit
- ❖ Regjistrimi i kërkesave për blerje dhe aprovimi i tyre
- ❖ Zotimet e bëra
- ❖ Aprovimi dhe certifikimi i pagesave
- ❖ Pagesat e bëra
- ❖ Evidenca analitike
- ❖ Shpërndarja e udhëzimeve personelit dhe menaxhimi me mjetet e drejtorisë
- ❖ Organizimi i ekskursioneve me nxënës me përmajtje:
- ❖ mësimi, edukimi dhe rekreacioni.

Kualitative:

1. Numri i lëndëve që do të kryhen në mënyrë analitike: Punët e planifikuara në bazë të projekteve për vitet 2019-2021 kërkojnë mjete buxhetore për realizimin projekteve sipas periodave të caktuara mujore, tremujore dh vjetore. Kjo mund të ketë rezultat pozitiv dhe kualitet më të lartë në realizimin, e projekteve, nëse aprovohet projekt-buxheti i kërkuar nga DKA-ja, ndërsa po që se nuk aprovohet ashtu siç është projektuar, për pasojë do të jet: Suksesi jo i mirë i nxënësve dhe projektet nuk do të realizohen në tërësi sipas planifikimit.

Drejtoria e kulturës, rinisë dhe sportit**Drejtoria për kulturë, rini dhe sport**

Deklarata e misionit: DKRS organizon, menaxhon dhe koordinon veprimtaritë kulturore, aktivitetet rinore dhe sportive. Koordinon punën me veprimtaritë në kompetencë me komunat tjera dhe asociacionet, shoqatat dhe organizatat.

Kujdeset për trashigiminë kulturore dhe për gjithë infrastrukturën ku zhvillohen aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive, si dhe bibliotekat.

Zyra për rini

Deklarata e misionit : Organizon dhe përkrah aktivitetet rinore me rëndësi shoqërore dhe kulturo-sportive. Koordinon punën me OJQ dhe shoqata rinore. Planifikon dhe raporton për punën vjetore..

Zyra për sport

Deklarata e misionit: Organizon garat sportive. Mbikqyrë garat sportive. Koordinon dhe mbështet veprimtaritë e klubeve sportive. Koordinon bashkëpunimin me qendrat sportive.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | 2019 | 2020 | 2021 |
|----------------------|------|------|------|
| | | | |

| | | | | |
|-------------------------------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 63.436 | 63.436 | 63.436 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 174.760 | 174.760 | 174.760 |
| 3. | Shpenzimet komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | 70.000 | 70.000 | 70.000 |
| 5. | Kapitale | | | |
| | Totali: | 308.196 | 308.196 | 308.196 |
| Numri i të punësuarve: | | 8 | 8 | 8 |

| |
|--|
| Kuantitative: |
| <ul style="list-style-type: none"> ❖ Takime koordinuese me subjektet e kulturës dhe artit ❖ Mirëmbajtja dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë ❖ Realizimi i Projektve në bazë të konkursit ❖ Biblioteka ❖ Trajnime ❖ Organizim i aktiviteteve ❖ Halla sportive ❖ Festivalet (MUZIKORE, TEATRORE) ❖ Garat e recituesëve ❖ Dita e dëshmorëve ❖ Dita e lirisë ❖ Takimet e kulturës ❖ Dita e rinisë ❖ Aktivitete rinore me rëndësi shoqërore ❖ Ekspozita të artit figurativ ❖ Zhvillimi i veprimtarive ❖ Ansambli i valleve ❖ Klubet sportive ❖ SHKA ❖ Grupe muzikore të rinjve ❖ Turne sportive |
| Kualitative: |

- Takime koordinuese me subjektet e kulturës, artit
- Mirëmbajtja dhe restaurimi i objekteve të trashigimisë
- Përkrahja nga buxheti për realizimin e projekteve teatrore, muzikore dhe të artit figurat
- Pasurimi i fondit të librit me botime të reja dhe botimi i librave të krijuesve të rinj.
- Takime të rregullta me asocionet kulturore, shoqatat, teatrot dhe trajnime
- Mbështetje organizative, teknike dhe profesionale për shkollat, asocionet, shoqatat dhe grupet e entiteteve të cilat veprojnë në komunë
- Aktivizimi i hallës sportive ndihmon zhvillimin e sporteve të vogla duke krijuar hapësirë për të gjitha entitetet dhe komunitetin sportive.

Drejtoria e shërbimeve publike

Deklarata e misionit : Drejtoria për Shërbime Publike, ka për detyrë ngritjen e cilësisë dhe zgjerimin shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë: trajtimin e ujërave të zeza(kanalizimin fekal);mbeturinat (bashkëpunimin me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave);furnizimi me ujë të pijës(bashkëpunimi me kompaninë e ujësjellësit); zgjerimin e sistemit të ndriçimit publik;sigurimin dhe mirëmbajtjen parqeve publike ; lëshimin e lejeve për shërbime ,siç janë lejet për shfrytëzimit të përkohshëm të hapësirave publike, lejet për orarin e udhëtimeve për operatorët e transportit të udhëtarëve, shërbimet e auto dhe radio-taksive; përmirësimin e infrastrukturës ligjore(Rregulloreve) për transportin lokal publik;përkujdesja dhe përmirësimi i shenjzimit verikal dhe horizontal ;

Planifikimin dhe caktimin e prioriteteve të projekteve të infrastrukturës dhe përcjelljen e realizimit të tyre.

Planifikimin e mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve,shesheve dhe hapësirave tjera publike.

Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve në mes të Drejtorive,poasçërisht me Drejtorinë e Inspeksionit dhe Drejtorinë e Urbanizmit,me kompanitë publike për shërbime.

Deklarata e Vizionit : Të arrijë përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët, duke bashkëpunuar me kompanit publike kompetente për shërbime me cilësore,të ujit,rrymës dhe menaxhimit të mbeturinave, përmirësimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik,zgjerimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik ,mirëmbajtje më cilësore verore dhe dimërore të rrugëve, shesheve, trotuareve dhe hapësirave

gjelbëruese, largimin e deponive të egra dhe mbeturinave, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, ndërtimin e urave, trotuareve, etj. .

Deklarata e Qëllimit : Realizimi i Programit, misionit dhe vizionit.

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|-------------------------------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 33.000 | 33.000 | 33.000 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 37.000 | 37.000 | 37.000 |
| 3. | Shpenzimet komunale | 149.954 | 149.954 | 149.954 |
| 4. | Subvencione dhe transfere | | | |
| 5. | Kapitale | 622.934 | 622.934 | 622.934 |
| | Totali: | 842.887 | 842.887 | 842.887 |
| Numri i të punësuarve: | | 5 | 5 | 5 |

Kuantitative:

- Punimi i Projekteve Ideore
- Përgatitja e Rregulloreve nga lëmija e shërbimeve publike dhe emergjencës
- Projektet e ndriçimit të rrugëve në qytet
- .Projektet e eliminimit të deponive të egra dhe rehabilitimi i tyre
- Lokacionet e Tregut të Gjëlber dhe Tregut me Shumicë
- .Pajisja me leje pune dhe licencë për transportuesit lokal
- Projekti për Eliminimin e qenve endacak
- Projekti për sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve
- Projekti për pastrim të mbeturinave nga rrugët dhe sheshet e

| |
|---|
| <p>qytetit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekti për larjen verore të rrugëve dhe shesheve të qytetit - Projekti për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe trotuareve në territorin e komunës. |
| Kualitative: |
| <p>Mbikëqyrja: Çdo projekt infrastrukturor, në bazë të ligjit, është i obliguar që të ketë mbikëqyrje profesionale dhe ekspertë nga lëmija përkatëse.</p> <p>Mbikëqyrja do të ndikojë në kualitetin e punimeve, funksionalitetin dhe stabilitetin projektit..</p> <p>Përpilimi i rregulloreve : Drejtoria do të bëjë përgatitjen për hartimin e rregulloreve të ndryshme nga lëmia e shërbime publike .</p> |

Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim (Emergjencia)

| |
|--|
| <p>Deklarata e misionit: Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim- Emergjencia ka për detyrë hartimin e Planeve operative në bazë të Ligjit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;përgatitjen dhe veprimin sipas Planit operativ të bazuar në Planin e vlerësimit të rrezikshmërisë;</p> <p>Koordinimi i veprimeve me institucionet tjera për emergjencia dhe siguri,siç janë : Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave, Qendra Operative Emergjente Rajonale,Policia e Kosovës,Forca e Sigurisë e Kosovës,Shërbimi i Zjarrfikjes, KFOR,etj.</p> |
| <p>Deklarata e Qëllimit : Realizimi i Programit,misionit dhe vizionit.</p> |

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|----------------------|------------------|---------|---------|---------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 154.947 | 154.947 | 154.947 |

| | | | | |
|-------------------------------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 2. | Mallra dhe shërbime | 10.500 | 10.500 | 10.500 |
| 3. | Shpenzimet komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | | | |
| 5. | Kapitale | 30.000 | 30.000 | 30.000 |
| | Totali: | 195.447 | 195.447 | 195.447 |
| Numri i të punësuarve: | | 23 | 23 | 23 |

| |
|--|
| Kuantitative: |
| <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përgatitja e Rregulloreve nga lëmija e emergjencës ➤ Hartimi i Planit të Vlerësimit të rreziqeve në Komunë (rivlerësimet-çdo vit) ➤ Intervenimet për rastet emergjente |
| Kualitative: Realizimi i Programit, misionit dhe vizionit. |

Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural

| |
|---|
| Deklarata e misionit : Harton, zbaton dhe mbikqyrë politikat zhvillimore në fushën e bujqësisë, e bën mbrojtjen dhe kultivimin e pyjeve |
| Deklarata e vizionit : Bujqësi të zhvilluar me planifikim të bazuar në resurset humane dhe natyrore që ka komuna. |
| Deklarata e qëllimit : Shfrytëzimi resurseve njerëzore dhe natyrore, përmirësim të strukturës prodhuese në blegtori, perim-kulturë, pemëtari apikulture (bletari) dhe administrim e menaxhim efikas . |

Performanca:

| Kategoritë buxhetore | | 2019 | 2020 | 2021 |
|-------------------------------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1. | Paga dhe mëditje | 57.574 | 57.574 | 57.574 |
| 2. | Mallra dhe shërbime | 12.000 | 12.000 | 12.000 |
| 3. | Shpenzimet komunale | | | |
| 4. | Subvencione dhe transfere | 120.000 | 120.000 | 120.000 |
| 5. | Kapitale | | | |
| | Totali: | 189.574 | 189.574 | 189.574 |
| Numri i të punësuarve: | | 11 | 11 | 11 |

Kuantitative:

- Hartimi i planit për mbjelljet pranverore dhe vjeshtore .
- Këshillime, përgatitjen e tokës, zgjedhjen e farës, mbrojtjen nga sëmundjet etj;
- Kultivimi dhe evidentimi i gjedheve.
- Këshillime, për mirëmbajtjen, higjienën dhe shtimin e tyre .
- Rritja e prodhimtarisë së qumështit mishit , etj.
- Këshillime rreth kultivimi, varieteti, dhe përdorimit të pesticideve.
- Rritja e sipërfaqeve me serra.
- Këshillime për punët rreth mbjelljeve për pemishtet e reja.
- Mbrojtja nga sëmundjet dhe dëmtuesit.
- Përmirësimi i kushteve jetësore,
- Rregullimi i infrastrukturës.

Kualitative:

- Me rregullimin e infrastrukturës në mënyra direkte bëhet ndihma e bujqve dhe indirekt përfitoni numër i madh i njerëzve dhe fshatrave.
- Bëhet punimi më i madh i sipërfaqeve të tokës.

- Do të bëhet rregullimi i jetës dhe do të ndalet shpërngulja e njerëzve fshat- qytet,
- Punësimi sezonal
- Përmirësimi i standardeve.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Drejtori,

Valon Mazreku